



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE (KQZ), në mbështetje të nenit 64, paragrafi 2, nën paragrafi 2.1 dhe 2.2, neneve 54, 55, 58 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), si dhe neneve 19, 20 dhe 29, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (LZL), me datën 08.03.2024, miraton këtë:

RREGULLORE ZGJEDHORE NR. 08/2024

VËZHguesIT E ZGJEDHJEVE

Neni 1

Qëllimi

Kjo Rregullore përcakton procedurën për aplikim, shqyrtimin e aplikacioneve dhe akreditimin e organizatave vëzhguese dhe mediave, si dhe të drejtat dhe detyrat e organizatave vëzhguese të akredituara dhe vëzhguesve të tyre.

Neni 2

Akreditimi i organizatave dhe i vëzhguesve të tyre

1. Subjektet politike të certifikuar, organizatat jo qeveritare (OJQ), organizatat qeveritare e ndërqeveritare, organizatat ndërkombëtare të specializuara të cilat merren me zgjedhjet dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe përfaqësuesit e vendeve të huaja, kanë të drejtë të aplikojnë për akreditim të vëzhguesve për zgjedhje.
 - 1.1. OJQ që në fushëveprimin e tyre merren me zgjedhjet dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut mund të vëzhgojnë procesin zgjedhor.
2. Kërkesën për akreditim të vëzhguesve, çdo subjekt politik i certifikuar mund ta parashtrijë në çdo kohë pranë KQZ, më së voni deri njëzetepesë (25) ditë para ditës së zgjedhjeve.
3. Kërkesën për akreditim të vëzhguesve, çdo organizatë jo qeveritare, qeveritare, ndërqeveritare, organizata ndërkombëtare, përfaqësuesit e vendeve të huaja, mund ta parashtrijë në çdo kohë pranë KQZ, më së voni deri në pesëmbëdhjetë (15) ditë para ditës së zgjedhjeve.
4. Kërkesën për akreditim të vëzhguesve, çdo medium mund ta parashtrijë në çdo kohë pranë KQZ, më së voni deri në ditën e pestë (5) ditë para ditës së zgjedhjeve.

Neni 3

Aplikimi dhe shqyrtimi i aplikacioneve

1. Subjektet politike të certifikuara, organizatat jo qeveritare, qeveritare, ndërqeveritare, organizata ndërkombëtare, përfaqësuesit e vendeve të huaja dhe media që aplikojnë për akreditim, duhet të plotësojnë dokumentacionin si në vijim:
 - 1.1. Formularin e akreditimit të organizatës vëzhguese – shtojca I;
 - 1.2. listën e vëzhguesve – shtojca II, që përmban:
 - 1.2.1. Emrin, mbiemrin, datën e lindjes, numrin personal dhe numrin e telefonit për kontaktim për secilin vëzhgues, në formën fizike dhe elektronike.
2. Zyra për Regjistrimin, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (Zyra), verifikon dokumentet e dorëzuara nga organizata për akreditim dhe dërgon shkresën për korrigjim të dokumentacionit:
 - 2.1. Brenda pesë (5) ditëve për subjektet politike;
 - 2.2. brenda njëzet e katër (24) orëve për organizatat;
 - 2.3. brenda tetë (8) orëve për mediat.
3. Organizatat që ka aplikuar për akreditim dhe që ka pranuar shkresën për korrigjim të dokumentacionit si në paragrafin 1 të këtij neni, duhet t'i bëjë korrigjimet e vëna në dukje dhe t'i ri dorëzojë ato dokumente tek Zyra:
 - 3.1. Brenda tri (3) ditëve nga njoftimi për subjektet politike;
 - 3.2. brenda njëzet e katër (24) orëve për organizatat;
 - 3.3. brenda tetë (8) orëve për mediat.
4. KQZ miraton ose refuzon kërkesat e:
 - 4.1. Subjekteve politike të certifikuara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë pas parashtrimit të saj;
 - 4.2. organizatave, jo më vonë se pesë (5) ditë pas parashtrimit të saj;
 - 4.3. mediave, jo më vonë se dy (2) ditë pas parashtrimit të saj;
 - 4.4. në rast të refuzimit të kërkesës për akreditim KQZ, përmes Zyrës, njofton me shkrim organizatën përkatëse dhe e informon për të drejtën e ankimit ndaj atij vendimi në Panelin Zgjedor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), dyzet e tetë (48) orë prej momentit të marrjes së njoftimit.
5. Zyra njofton organizatën për akreditimin e vëzhguesve të saj nga KQZ dhe e pajisë me vendim të akreditimit dhe distinktivët e veçantë për të gjithë vëzhguesit.

6. Pranimi i distinktivëve për vëzhguesit bëhet nga përfaqësuesi i autorizuar organizatës së akredituar, i cili është i obliguar të nënshkruaj në listën e pranim-dorëzimit.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrat e organizatave të akredituara dhe të vëzhguesve të tyre

1. Vëzhguesi ka të drejtë të:
 - 1.1. Vëzhgojë, pa u penguar, përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve, përfshirë takimet pas ditës së zgjedhjeve, dëgjimet dhe aktivitetet lidhur me zgjedhjet, ankesat dhe parashtrirat lidhur me rezultatet e zgjedhjeve dhe përcaktimin e kandidatëve fitues;
 - 1.2. parashtrijë komente me shkrim komisioneve zgjedhore dhe këshillave të vendotimeve;
 - 1.3. vëzhgojë paketimin, transferimin, dorëzimin, trajtimin, numërimin, ruajtjen e sigurt dhe shkatërrimin e fletëvotimeve;
 - 1.4. pajiset me kopjet e vendimeve, protokollet, tabelat, procesverbalet dhe dokumentacionin tjetër gjatë gjithë procesit zgjedhor, përfshirë proceset para dhe pas ditës së zgjedhjeve.
2. Gjatë procesit zgjedhor, përfshirë edhe procesin e regjistrimit të votuesve, vëzhguesi i akredituar mund të parashtrijë ankesë për çfarëdo shkelje të Rregulloreve në fuqi, Urdhëresave Administrative, Rregullave Zgjedhore ose Procedurave Administrative pranë KQZ-së në pajtim me procedurat e saj.
3. Vëzhguesi ka për detyrë të:
 - 3.1. Respektojë kërkesat e këtij ligji dhe rregullat e KQZ-së;
 - 3.2. mbajë distinktivin e identitetit të vëzhguesit në mënyrë të dukshme kur është i angazhuar në aktivitete të vëzhgimit;
 - 3.3. përmbahet nga bartja e shenjave dalluese të cilat shërbejnë si mjete propaganduese ose që mund të ndikojnë në dëshirën e votuesit ose e identifikon atë me një parti të caktuar politike ose kandidat; dhe
 - 3.4. përmbahet nga shkelja e të drejtës së votuesit për fshehtësi të fletëvotimit dhe nga pengimi i procesit të të votuarit dhe administrimit të zgjedhjeve.
4. Një organizatë e akredituar vëzhguese mund të dërgojë një vëzhgues në takimet e KQZ-së dhe KKZ-së.
5. Organizata e akredituar është përgjegjëse dhe duhet të sigurojë që vëzhguesit e saj janë plotësisht të informuar me të drejtat dhe obligimet si dhe me procesin zgjedhor.
6. Organizata e akredituar është përgjegjëse për sjelljen individuale të vëzhguesve të saj.

7. Nëse organizata e akredituar konstaton se ndonjëri nga vëzhguesit e saj ka shkelur kodin e sjelljes për vëzhgues, ajo duhet t'ia tërheqë distinktivin vëzhguesit dhe t'ia dorëzojë atë KQZ në mënyrë që t'i anulohet akreditimi.
8. KQZ në çdo kohë mund ta anulojë akreditimin e vëzhguesit që cenon LZP, Rregulloret e KQZ, urdhëresat ose procedurat administrative lidhur me procesin zgjedhor.

Neni 5

Akreditimi dhe roli i mediave

1. Stafit i mediave të shkruara apo atyre elektronike (shtëpive mediatike) të cilët duan të hyjnë në qendër të votimit (QV), në vendvotim (VV), në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) apo në Qendrën për Numërim dhe Rezultate (QNR) në ditën e zgjedhjeve apo gjatë numërimit, duhet të jenë të akredituara nga KQZ.
2. Lista duhet të përmbajë të dhënat dhe dokumentet si më poshtë:
 - 2.1. Emrin e shtëpisë mediatike dhe kopja e certifikatës së regjistrimit;
 - 2.2. emrin, mbiemrin, datën e lindjes, numrin personal dhe numrin e telefonit për kontaktim për secilin vëzhgues, në formën elektronike;
3. Pas vendimit të KQZ për akreditim, Zyra pajisë shtëpitë mediatike me distinktivët për akreditim të vëzhguesve.
4. Vëzhguesi i akredituar i medias duhet ti bartë së bashku distinktivin e akreditimit me dokumentin identifikues të mediumit që përfaqëson dhe sigurohet që të njëjtat të jenë të dukshme gjatë kohës së vëzhgimit dhe ka të drejtë:
 - 4.1. Të hyjë në QV, VV, QKN dhe QNR, si dhe në objektet tjera të KQZ dhe Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), që janë të hapura për publikun dhe mediat;
 - 4.2. të marrë pamje me kamerë dhe fotografi.
5. Aktiviteti i stafit të mediave nuk duhet të cenojë integritetin e procesit zgjedhor, heshtjen zgjedhore, privatësinë dhe fshehtësinë e votës.
6. KQZ në çdo kohë mund të tërheqë akreditimin e stafit të një medie, në rast të shkeljes së dispozitave të legjislacionit zgjedhor.

Neni 6

Roli i vëzhguesve gjatë zgjedhjeve

1. Vëzhguesit mund të vëzhgojnë procesin e vlerësimit të pakove me fletëvotime të dërguara nga votuesit jashtë Kosovës, procesin e hapjes së VV, votimin, numërimin, paketimin dhe dorëzimin e materialit nga VV te KKZ dhe nga KKZ në QKN, me përjashtim të shënimit të fletëvotimit nga votuesi.

2. Jo më shumë se një vëzhgues nga organizata e njëjtë e akredituar mund të jetë i/e pranishëm në të njëjtën gjatë proceseve të parapara sikurse në paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 7

Vëzhgimi i procesit të numërimit të fletëvotimeve në vendvotim nga mediat e akredituara

1. Numërimi i fletëvotimeve në vendvotim mund të vëzhgohet nga mediat e akredituara, të cilat lejohen të filmojnë dhe fotografojnë.
2. Varësisht nga hapësira e VV, kryesuesi i VV cakton numrin e mediave që mund të përcjellin numërimin në një VV.
3. Përfaqësuesi i medias së akredituar duhet të paraqesë kërkesë te kryesuesi i VV për vëzhgimin e procesit të numërimit në VV e caktuar, para fillimit të procesit të numërimit. kryesuesi i KVV e regjistron kërkesën në librin të votimit, duke shënuar të dhënat e vëzhguesit të akredituar të medias.
4. Kryesuesi i VV duhet t'i njoftojë mediat se mund të filmojnë procesin e numërimit të fletëvotimeve, por pa paraqitur të dhënat personale të mbrojtura me ligj.
5. Përfaqësuesit e mediave qëndrojnë në vendin që u caktohet nga kryesuesi, në një largësi të përshtatshme nga tavolinat e punës dhe e kanë të ndaluar të kenë kontakt fizik me materialet zgjedhore, të pengojnë procesin e numërimit të fletëvotimeve apo të komunikojnë me anëtarët e KVV.
6. Përfaqësuesit e mediave që largohen nga vendvotimi gjatë procesit të numërimit, nuk mund të kthehen prapë në VV.

Neni 8

Vëzhgimi i procesit të numërimit në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN)

1. Të gjitha aktivitetet që zhvillohen në QKN, mund të vëzhgohen nga vëzhguesit dhe mediat e akredituara.
2. Brenda QKN, vëzhgimi i lejohet jo më shumë se një vëzhguesi, nga e njëjta organizatë e akredituar, për secilën tavolinë të numërimit.
3. Subjektet politike obligohen që të dërgojnë listën e vëzhguesve që do të vëzhgojnë procesin brenda QKN.
4. Vëzhguesit qëndrojnë përballë grupeve të numërimit, në një largësi të përshtatshme nga tavolinat e punës dhe e kanë të ndaluar të kenë kontakt fizik me materialet zgjedhore.
5. KKZ verifikon vëzhguesit dhe lejon qasjen në QKN, sipas vendimit të KQZ.

Neni 9

Vëzhgimi i procesit të numërimit të votave të kandidatëve në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve

1. Të gjitha aktivitetet që zhvillohen në QNR, mund të vëzhgohen nga vëzhguesit dhe mediat e akredituara.
2. Brenda QNR, vëzhgimi i lejohej jo më shumë se një vëzhguesi nga e njëjta organizatë e akredituar, për secilën tavolinë të numërimit.
3. Subjektet politike obligohen që të dërgojnë listën e vëzhguesve që do të vëzhgojnë procesin brenda QNR.
4. Vëzhguesit qëndrojnë përballë grupeve të numërimit, në një largësi të përshtatshme nga tavolinat e punës dhe e kanë të ndaluar të kenë kontakt fizik me materialet zgjedhore.

Neni 10

Vëzhgimi i procesit të vlerësimit të pakove me fletëvotime nga votimi jashtë Kosovës

1. Vëzhguesi dhe mediat e akredituara, mund të vëzhgojnë procesin e vlerësimit të pakove me fletëvotime, të dërguara nga votuesit jashtë Kosovës.
2. Në hapësirën ku bëhet vlerësimi i pakove me fletëvotime, vëzhgimi i lejohej jo më shumë se një vëzhguesi, nga e njëjta organizatë e akredituar, për secilën tavolinë të numërimit.
3. Gjatë procesit të vëzhgimit, vëzhguesit nuk i lejohej qasje në të dhënat personale të votuesve, të mbrojtura sipas Ligjit për të dhënat personale.

Neni 11

Vëzhguesit e zgjedhjeve për raundin e dytë të zgjedhjeve

1. Vëzhguesit e akredituar para ditës së zgjedhjeve të raundit të parë, mund të vëzhgojnë raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave.
2. Përfaqësuesit e subjekteve politike të certifikuara, OJQ-ve, organizatave qeveritare dhe ndërqeveritare, organizatave ndërkombëtare që janë të specializuara dhe të angazhuara në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfaqësuesit e vendeve të huaja apo mediave, mund të aplikojnë në KQZ për t'u akredituar për vëzhgimin e raundit të dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave, ose nëse tashmë janë të akredituar si organizatë e vëzhguesve, mund të dorëzojnë kërkesën për akreditim të vëzhguesve shtesë, jo më vonë se pesë (5) ditë para ditës së zgjedhjeve.

Neni 12

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregulla zgjedhore nr.08/2023 Vëzhguesit e Zgjedhjeve.
2. Pjesë përbërëse të kësaj Rregullore janë:
 - 2.1. Shtojca I – formulari i akreditimit të organizatës vëzhguese;
 - 2.2. shtojca II – lista e vëzhguesve;
3. Brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve pas hyrjes në fuqi të kësaj rregullore, Zyra obligohet që ta hartoj procedurën për akreditimin e vëzhguesve dhe udhëzuesin për kodin e sjelljes së vëzhguesve.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit.

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi